



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2774 Prot.

Tiranë, më 19.5. 2020

Lënda: Mbi masat për zhvillimin e provimeve në seksionet dygjuhëshe

**Drejtuar:** AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË ITALISË  
Tiranë  
AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË FRANCËS  
Tiranë  
AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË GJERMANISË  
Tiranë  
QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE  
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Tiranë  
DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Durrës  
DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Korçë  
DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
Lezhë

Në kushtet e reja të pandemisë COVID 2019 dhe në vijim të komunikimit me përfaqësuesit e ambasadave dhe institucioneve arsimore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, lidhur me organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore (MSH) 2020 për seksionet dygjuhëshe dhe të provimeve “Lingua e literatura italiana” dhe “DELFI Scolaire”, ju bëjmë me dije se provimet do të zhvillohen në zbatim të marrjes së masave si më poshtë vijon:

**1. Seksioni dygjuhësh shqiptaro-italian**

**a) Provimi “Lingua e literatura italiana”**

- Zhvillohet më datë 25 maj 2020, në mjediset e secilit seksion.
- Provimi fillon më 10:00 dhe mbaron më 12:00.
- Teza e provimit do të dërgohet në rrugë elektronike në secilën shkollë nga Zyra e Shkollave në Ambasadën Italiane në orën 9:00 të datës 25 maj 2020.
- Testi do të përmbajë pyetje nga lënda e zhvilluar deri në fund të muajit shkurt 2020.

- Testi do të hartohet nga mësuesit italianë dhe do të korrigojë në mjediset e secilit seksion nga mësuesit italianë dhe/ose nga ata shqiptarë të seksioneve dygjuhëshe.
- Provimi do të administrohet nga mësuesit italianë dhe shqiptarë, por jo të lëndës.
- Vëzhgues nga Ministrinë përkatëse janë: Znj. Carlotta D'Amico në Korçë, znj. Lucia Cucarelli në Shkodër dhe znj. Tatjana Vuçani në Tiranë.

**b) Provimet e MSH për lëndën Matematikë dhe lëndët me zgjedhje**

- Provimi i Matematikës zhvillohet më datë 15 qershor 2020 dhe provimi i lëndëve me zgjedhje (Histori dhe Fizikë) më 18 qershor 2020 në mjediset e secilit seksion.
- Provimet fillojnë më 10:00 dhe mbarojnë më 12:00
- Teza e provimit do të dërgohet zyrtarisht nga ambasada e Italisë në QSHA deri më 25 maj 2020.
- Testi do të përmbajë pyetje nga lënda e zhvilluar deri në fund të muajit shkurt 2020.
- Testi do të jetë me alternativa dhe ka 30 pyetje, secila nga 2 pikë.
- Testi do të hartohet nga mësuesit italianë dhe do të korrigojë nga mësuesit shqiptarë të seksionit.
- Provimi do të administrohet nga mësuesit italianë dhe shqiptarë, por jo të lëndës.

**2. Seksioni dygjuhësh shqiptaro-francez**

**a) Provimi gjuhës frënge "DELF scolaire"**

- Zhvillohet më datë 25 maj 2020, në mjediset e secilit seksion.
- Testi do të hartohet sipas standardit të provimit "DELF Scolaire" me shkrim dhe gojë.
- Provimi me shkrim fillon më 10:00 dhe mbaron më 12:30.
- Provimi me gojë fillon më 14:30 të datës 25 maj 2020 dhe përfundon në orën 18:00.
- Teza e provimit do të dërgohet me DHL te përgjegjësit e seksioneve.
- Juritë e mësuesve mbikëqyrës dhe korrigjues përbëhen, si edhe në vitet e kaluara, nga mësues për mbikëqyrjen dhe korrigjimin të aprovuar nga France Education International.
- Ambasada do t'u dërgojë drejtuesve të seksioneve me mesazh elektronik pak para provimit transmetimin e regjistrimeve, tezat e provimit me gojë dhe përgjigjet. Ky material u përcillet mësuesve mbikëqyrës dhe korrigjues.
- Vëzhgues në provime do të jenë përfaqësues të Drejtorisë Rajonale Arsimore Parauniversitare (DRAP) Korçë, DRAP Lezhë dhe DRAP Durrës.

**3. Seksioni dygjuhësh shqiptaro-gjerman**

**a) Provimet e MSH për lëndën Matematikë dhe lëndët me zgjedhje**

- Provimi i Matematikës zhvillohet më datë 15 qershor 2020 dhe lënda me zgjedhje (Gjeografi ) më 18 qershor 2020 në mjediset e seksionit në zbatim të Urdhrit nr. 289, datë 04.05.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e udhëzuesit për "Masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore".
- Provimet fillojnë më 10:00 dhe mbarojnë më 12:00.
- Teza e provimit do të dërgohet zyrtarisht nga përfaqësuesja e Zyra Federale e Arsimit të Gjermanisë në QSHA deri më 25 maj 2020.
- Testi do të përmbajë pyetje nga lënda e zhvilluar deri në fund të muajit shkurt 2020.
- Testi do të jetë me alternativa sipas standardit të QSHA-së.

- Testi do të hartohet nga mësuesi gjerman dhe do të korrigojohet nga QSHA.
- Provimi do të administrohet nga mësuesit shqiptarë, por jo të lëndës.

Këto provime do të zhvillohen në zbatim të rregullores së MSH-së dhe në zbatim të Urdhrit nr. 289, datë 04.05.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për miratimin e udhëzuesit për “Masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”.

Zyrat vendore arsimore dhe shkollat do të marrin masa për zbatimin e rregullave të higjienës dhe distancimit fizik sipas urdhrit më sipër dhe për pajisjen me maska dhe doreza për nxënësit dhe mësuesit, administratorët dhe korrigjuesit.

QSHA do të marrë masa për korrigjimin e testeve, në zbatim të protokollit të institucioneve shëndetësore.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë u paraqet komplimentet e saj ambasadës së Republikës së Italisë, ambasadës së Republikës së Francës dhe ambasadës së Republikës së Gjermanisë në Tiranë dhe ka nderin t’i sigurojë për organizimin e suksesshëm të provimeve dhe t’i falënderojë për bashkëpunimin.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Oltjon MUZAKA**

